

THIRRJE PUBLIKE

PËR PËRZGJEDHJEN E PERSONIT JURIDIK QË KRYEN VEPRIMTARI OSE ZOTËRON LICENCË PËR GRUMBULLIMIN DHE / OSE TRANSPORTIMIN E PËRPUNIMIT, RICIKLIMIT DHE ASGJËSIMIN E MBETURINAVE

Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut, bazuar në nenin 42 paragrafi 3 të Ligjit të Përdorimit dhe të Zotërimit të Gjësendeve në Pronësi Shtetërore dhe Komunale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 78/15, 106/15, 153/15, 190/16 dhe 21/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.101/19,275/19 dhe 122/21) dhe vendimin për dhënien e pëlqimit të kryerjes së një procedure për përzgjedhje të personit juridik që kryen veprimtari ose zotëron licencë për grumbullimin dhe/ose transportimin, përpunimin, riciklimin dhe asgjësimin e mbeturinave nr. 40-6814 / 1, datë 13.7.2021, e miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 162/2021), shpall thirrje publike për përzgjedhjen e personave juridikë që kryejnë veprimtari ose zotërojnë licencë për grumbullimin dhe/ose transportimin, përpunimin, riciklimin dhe asgjësimin e mbeturinave për gjësendet e lëvizshme që nuk kanë vlerë, respektivisht. për shkak të vjetërsisë, mospërdorshmërisë ose vjetërsimit teknologjik nuk përdoren nga Agjencia e Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Thirrja publike është e pandashme

Personi juridik i përzgjedhur në thirrjen publike ka obligim të marrë gjësendet e lëvizshme, që i nënshtrohen thirrjes publike t'i selektojë dhe t'i transportojë ato si mbeturina, në një mënyrë të përshtatshme, në përputhje me Ligjin e Shfrytëzimit dhe të Zotërimit të Gjësendeve në Pronësi Shtetërore dhe Komunale, Ligjin e Menaxhimit të Mbeturinave dhe Ligjin e Menaxhimit të Pajisjeve Elektrike dhe Elektronike si dhe të Mbeturinave Elektrike dhe Elektronike.

Gjësendet e lëvizshme gjenden në lokacionet e mëposhtme:

1	Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë - Shërbimi Qendror Rr."Vasil Gjorgjov" nr.43, Shkup
2	Sava Kovacevic bb Shkup, (magazina në Kisela Vodë)
3	Qendra e Punësimit Berovo, Rruga "Mareshali Tito" 19, Berovë
4	Qendra e Punësimit Manastir, "Gjorce Petrov" bb. Manastir
5	Qendra e Punësimit Valandovo, Rruga "4 Korriku" Nr. 5, Valandovë
6	Qendra e Punësimit Veles, Rruga "Petre Prlichkov" 34, Veles
7	Qendra e Punësimit Vinicë, "Mareshali Tito" bb, Vinicë
8	Qendra e Punësimit Gjevgjeli, Rruga "Boris Karpuzo" 1, Gjevgjeli
9	Qendra e Punësimit Gostivar, shëtitoria "Vardar" br.1, Gostivar
10	Qendra e Punësimit Dibër, rr. 8 Shtatori nr.68, Dibër
11	Qendra e Punësimit Delçevë, bul. "Maqedonia" bb, Dellçevë
12	Qendra e Punësimit Demir Hisar, "Mareshali Tito" bb, Demir Hisar
13	Qendra e Punësimit Kavadarci, Rruga "7 Shtatori", nr. 74, Kavadar
14	Qendra e Punësimit Kërçovë, blv. "I Çlirimit" nr.39, Kërçovë
15	Qendra e Punësimit Kocani, Rruga "Veljko Vlahovi" 1. Rruga, Koçan
16	Qendra për Punësim Kumanovë, "Todor Velkov" bb, Kumanovë
17	Qendra për Punësim Kratovë, rr. "Goce Dellçev" nr.36, Kratovë
18	Qendra e Punësimit Kriva Pallankë, Rruga "Maershali Tito" 181, Kriva Pallankë
19	Qendra e Punësimit Krushevë, "Nikola Gjrkovi" pn, Krushevë
20	Qendra e Punësimit Makedonski Brod, "Rruga Partizanska" 10, Makedonski Brod
21	Qendra e Punësimit Probistip, "Miro Baraga" bb Probistip
22	Qendra e Punësimit Strumicë, ul."1 Maj" nr.36, Strumicë
23	Qendra e Punësimit Prilep, Rruga "Lado Lapecot" 100, Prilep
24	Qendra e Punësimit Radovish, "Mareshal Tito" bb, Radovish
25	Qendra e Punësimit Shtip, Rruga "Goce Dellçev" 91, Shtip
26	Qendra e Punësimit të Qytetit të Shkupit, Rruga "Vasil Gjorgov" 41, Shkup
27	Qendra e Punësimit Tetovë, Rruga "Blagoja Toska" 23, Tetovë

Të drejtë për pjesmarrje në thirrjen publike kanë të gjithë personat juridikë, që kanë licencë të vlefshme për grumbullimin dhe / ose transportimin, përpunimin, riciklimin dhe asgjësimin e mbeturinave (të drurit, metalit, plastikës dhe mbeturinave elektrike / elektronike) të lëshuar nga organ kompetent i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Lista e gjësendeve të lëvizshme – lëndë e kësaj Thirrje Publike, udhëzimet dhe dokumentacioni tjetër i nevojshëm në lidhje me Thirrjen Publike mund të merret nga Arkivi / Regjistri i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut - Shërbimi Qendror, në Rrugën "Vasil Gjorgov" nr 43 – Shkup ose në mënyrë elektronike në uebfaqen e Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut www.av.gov.mk

Afati i fundit i dorëzimit të aplikimeve është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e parë pas shpalljes së thirrjes publike.

Telefoni i kontaktit në lidhje me thirrjen publike: 02 / 3111-850, e-mail: info@av.gov.mk

AGJENCIA E PUNËSIMIT
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT